

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALDEA”SHPK

Sot me daten 19 Korrik 2021,une I nenshkruari:

1.Adrijon Marku,I datelindjes 29 Maj 1978,lindur ne Kavaje ,me banim ne 52072 ,Ahen,Kylvetershtrase 14,Gjermani I pajisur me leternjofimin me numer identifikimi H80529102N.

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit”,Hartojme Statusin e Shoqerise “ALDEA” SHPK,si me poshte:

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “ALDEA” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar.Veprimtarija e saj rregullohet sipas neneve te ketij statute dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008,si edhe Ligjit per QKB-ne.

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres ,Rruga Taulantia/1 ,Numer Pasurije 25/337/ND-N4,Zona Kadastrale 8512.

Shoqeria mund te krijoje filial ,zyra perfaqsimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Bar ,restorant.

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë "ALDEA" SHPK është 10.000 (dhjete mijë) leke.
Ky Kapital është i ndare në 1 kuotë

2. Adrijon Marku, zoteron 100% të kapitalit

NENI 5

MENYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- Shitblerjes,
- Trashegimise,
- Dhurimit,
- Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

NENI 6

ZMADHIMI E ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues në Shumen e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakeve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakeve. Shoqëria mund të vendosë zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblese së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar të votave.

NENI 7

KOHEGJATJA E SHOQERISE

Shoqerija do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te papercaktuar.

NENI 8

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e pergjithshme
- Administratoret.

NENI 9

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjise per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

NENI 10

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME.MENYRA E THIRRJES.

Mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit.

Asambleja e Pergjithshme thirret nga administrator te pakten 1 here ne vit,per miratimin e llogarive te shoqerise,por mbledhje te tjera mund te thirren gjate vitit per çeshtje nga me te ndryshmet.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar çdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik.Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes se mesiperme,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort,per te marre vendime,pavaresisht parregullsisë.

Kuorumi

-Ne rastin e marrjes se vendimeve,qe kerkojne nje shumice te zakonshme,asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave.Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje,te cilat kerkojne shumice te kualifikuar,sipas nenit 87 te ketij ligji,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht,votojne me shkrese,apo me mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

-Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur ne piken 1 te ketij neni ,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30dite,me te njenjtin rend dite.

Marrja e vendimeve

-Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte ,asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesmarres,sic percaktohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve ,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj ose ne statut,per çeshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij ligji,asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres.

-Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket ,apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre,te parashikuara ne ligj,ose ne statut,kushtezohet nga miratimi I ortakut perkates.

-Te gjitha vendimet e asamblese duhet te rregjistrohen ne proces verbal.

NENI 11

E DREJTA E VOTES

Çdo kuote I jep ortakut te pranishem apo perfaqsesit te tij te autorizuar te drejten e nje vote.

Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet,qe kane te bejne me kuotat,qe ai disponon.

NENI 12

ADMINISTRATORET

Administratoret e shoqerise do te jene 2 shtetasit :

1 . Gjergj Doçi ,i datelindjes 23 Tetor 1999 lindur ne Tirane, me banim ne rruga Stavri Themeli,banese private nr.9 ,I pajisur me leternjoftimin me numer identifikimi personal J91023054S,I cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare,me te drejte riparteritje te ketij afati.

2. Klodjan Agolli ,i datelindjes 09 Shtator 1989 lindur ne Shijak, me banim ne Sukth I Ri,banese private ,I pajisur me leternjoftimin me numer identifikimi personal I90909060Q,I cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare,me te drejte riparteritje te ketij afati.

Administratoret mund te shkarkohen ne çdo moment nga asambleja ,me shumice te thjeshte votive ,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 13

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen:

-Te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise,duke zbatuar politikat tregtare,te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme,

-Te perfaqsojne shoqerine tregtare,

-Te kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise,

-Te bejne te mundur pergatitjen nga specialist I ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te parashikues ne vitin e ardhshem,per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme,brenda dates 20 Tetor te vitit paraardhes,

- Te bejne te mundur pergatitjen nga specialist I ngarkuar dhe te nenshkruaje bilancin vjetor te mbyllur ,per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme,brenda dates 20 Mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe ,se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,i paraqet keto dokumenta perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim,

-Te krijojne nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,

-Te kryejne rregjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise,

-Te raportojne perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare,

-Te kryejne detyra te tjera,te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

NENI 14

SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Pjesa e fitimit qe I takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise,vendoset te shperndahet nga Asambleja e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t`u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te rregjistruar ,qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve ,por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalitfillestar vapo per qellime te tjera,te cilat ajo I konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 15

PRISHJA E SHOQERISE,LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE.

Prishja e shoqerise

Shoqerija priset:

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c)me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 per "QKR",

d)me vendim te gjykates,

dh)per arsye te tjera,te parashikuara ne statut.

Largimi I ortakut

-Ortaku mund te largohet nga shoqeria:

-nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij,

-nese eshte penguar te ushroje te drejtat e tij,

-nese shoqeria I ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo,

Per shkaqe te tjera,qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Perjashtimi I ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut,nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij,sipas parashikimeve te statutit,ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshmeper kete perjashtim,te parashikuara me ligj.

NENI 16

LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likuidimit te shoqerise,Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator,I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.Me vendimin e posaçem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve.Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te rregjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

NENI 17

FTESA PER KREDITORET

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj.Shoqeria publikon dy here kete njoftim ,me nje interval prej 30 ditesh,ne faqen e saj te

internetit,si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Biznesit.Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 18

PERFUNDIMI I LIKUIDIMIT

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura ,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon ç`rregjistrimin e shoqerise.Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas ç`rregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare te Biznesit.

NENI 19

Per sa nuk eshte parashikuar ne statut,do te behet referim ne dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar ne pergjithesi.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "ALDEA"SHPK

Adrijon Marku

